


TOOLKIT

# IDENTIFIKIMI I NARRATIVAVE TË KORNIZUARA NGA AI CHATBOTS

**Hyrje e shkurtër**

AI chatbots mund të japin përgjigje të sakta, por ndonjëherë mund të kornizojnë informacionin në një mënyrë që favorizon një këndvështrim të caktuar. Ky toolkit të ndihmon të dallosh shpejt kur një narrativë është e shtrembëruar, e anuar, ose e ndërtuar për të ndikuar perceptimin.

# SHENJAT KRYESORE TË NJË NARRATIVË TË KORNIZUAR

## 1

### PËRSËRITJE E TË NJËJTIT KËND

Al e shtyn diskutimin drejt një interpretimi të vetëm, edhe kur pyetja ndryshon.

## 2

### TONE EMOCIONALE TË EKZAGJERUARA

Rritje e frikës, panikut, shpresës së tepruar, dramës.

## 3

### PËRGJITHËSIME TË GJERA

Përdorimi i termave “gjithmonë”, “asnjëherë”, “të gjithë”, “askush”.

## 4

### ZGJEDHJE SELEKTIVE E FAKTEVE

Jep vetëm informacion që përputhet me narrativën; lë jashtë pjesë të rëndësishme.

## 5

### POLARIZIM I DUKSHËM

Ndarje artificiale “ne vs ata”, “e mirë vs e keqe”.

## 6

### THJESHTIM I TEPËRT I ÇËSHTJEVE TË NDËRLIKUARA

Probleme komplekse shpjegohen me zgjidhje shumë të shkurtra, shpesh të sakta.

## 7

### AUTORITET I RREMË OSE VETËBESIM I TEPËRT

Pretendon siguri absolute në tema që kërkojnë nuanca.

## PROCESI I SHPEJTË I VERIFIKIMIT

**Kontrollo pyetjen**

A është pyetje e ngarkuar emocionalisht ose me paragjykim që mund ta shtyjë AI-n në narrativë?

**Analizo mënyrën e të folurit të AI**

A po e shtyn diskutimin drejt një qëndrimi të vetëm?

**Pyet për burimet**

A i ofron burimet spontanisht? Janë të sakta? Apo mungojnë?

**Kërko perspektiva alternative**

Formulo pyetje si:
➡️ "A ka këndvështrime të tjera?"
Nëse AI e korrigjon veten → narrativë e paqëndrueshme.

**Krahaso përgjigjet e përsëritura**

Ndryshimi i narrativës me pyetje të vogla tregon kornizim të paqëndrueshëm ose të paqëllimshëm.

## DY SHEMBUJ TË SHKURTËR

❌ **Shembull i narrativës së kornizuar**

*"Organizatat e vogla asnjëherë nuk kanë fuqi të ndikojnë në dezinformim. Vetëm qeveritë mund të zgjidhin këtë problem."*

**Pse është i kornizuar:**

- Përgjithësim absolut
- Zbeh rolin e aktorëve të tjerë
- Krijon polarizim (qeveri vs OJQ)

✔️ **Version i Balancuar**

*"Organizatat e vogla shpesh kanë kapacitete të kufizuara, por ato kontribuojnë në mënyrë të rëndësishme me fact-checking lokal dhe edukim medial. Qeveritë luajnë rol tjetër, më strukturor."*

**Pse është i balancuar:**

- Jep nuancë
- Shmang absolutizimin
- Pranon rolin e palëve të ndryshme

## CHECKLIST I SHPEJTË PËR PËRDORUESIT

✔ A përmenden emocione të larta?
✔ A përdoren përgjithësime?
✔ A jepen vetëm disa fakte?
✔ A ka polarizim të dukshëm?
✔ A është përgjigja shumë e sigurt dhe e prerë?
✔ A shmangen burimet reale?
✔ A duket se po ndikohen mendimet e tua, jo vetëm informimi?

Nëse shumë kuti rezultojnë "✔", është e mundshme që narrativën e kornizon AI.

## Teknikat Kryesore të kornizimit që përdorin Chatbot-at

### 01 Kornizim emocional
Nxitim frike, zemërimi, simpati ose urrejtje.

### 02 Kornizimi selektiv
Fakte të zgjedhura për të mbështetur ide të caktuara.

### 03 Kornizimi simplifikues
Reduktim ekstrem i temave komplekse.

### 04 Kornizimi konfirmues
AI jep përgjigje që përputhen me pritshmëritë ose besimet e përdoruesit.

## KËSHILLA PËR TRAJNERËT

*(praktike, për përdorim në workshop/e)*

- Përdorni shembuj realë të përgjigjeve nga AI.
- Krahasojini me përgjigje alternative.
- Përdorni ushtrime “gjej narrativën”
- Përdorni qasje vizuale (ikona, shigjeta, krahasime).
- Fokusohuni në interpretim, jo në teknologji.

## MINI-FAQ

**A janë chatbot-at të paanshëm?**

- Jo gjithmonë; varen nga dataset-et, prompt-et dhe kufizimet.

**A e bëjnë qëllimisht kornizimin?**

- Zakonisht jo – por mund të ndodhë për shkak të bias-eve të të dhënave dhe interpretimit të pyetjeve.

**Si dalloj narrativën nga opinioni neutral?**

- Narrativa kornizon, ndikon, shtyn; opinioni neutral informon.